



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 67/1 Prot.

Tiranë, më 15/12/2011

Lënda: *Rekomandim për "Intermedica, Diagnostic Medical Center", Tiranë.*

REKOMANDIM

Nr. 67/1, datë 15/12/2011

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Intermedica, Diagnostic Medical Center", Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 04/11/2011, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, "Intermedica, Diagnostic Medical Center", Tiranë, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- 1- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- 2- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë autoritetit të Komisionerit, në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21);
- 3- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27);
- 4- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara, vëren se:

- 1) Kontrolluesi "Intermedica, Diagnostic Medical Center", Tiranë nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale".

Në këtë rast nuk është zbatuar Neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit “Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

- 2) Kontrolluesi, “Intermedica, Diagnostic Medical Center”, Tiranë, nuk ka hartuar një Rregullore të shkruar për mbrojtjen e të dhënave personale në zbatim të Nenit 27/2 “c”, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Moskryerja e këtij detyrimi ligjor përbën shkelje të kërkesave të Nenit 27/2/c të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”; “Kontrolluesi, udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave”. Gjithashtu, mungojnë politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet konfidencialitetit, të parashikuara në Nenin 28 të Ligjit.

Për sa më sipër, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të Kodit të Proçedurave Administrative:

REKOMANDOJ

1. Bazuar në nenet 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të realizoni njoftimin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat jeni përgjegjës, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh;
2. Bazuar në nenet 27/2 “c” dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartoni Rregullore të Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh.
3. Me kalimin e afatit, në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas Nenit 39 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

